

**Termet e Referencës për OSHC**  
**Për zbatimin e projekteve të vogla në mbështetje të grupeve të grave që punojnë për**  
**ngritjen e vetëdijes për dhunën në baza gjinore, me fokus në dhunën në familje**  
(Projekti 2100971, Aktiviteti 2.2: Mbështetja e strategjive të OSHC-ve për avokim për  
ndaljen e dhunës në baza gjinore)

**Informata të përgjithshme:**

Në kuadër të projektit të vet "Mbështetje mekanizmave të pjesëmarrjes për monitorimin dhe ndikimin në procedurat e vendimmarrjes", aktiviteti 2.2, Seksioni për Pjesëmarrje Publike (SPP) pranë Departamentit për Demokratizim të Misionit të OSBE-së në Kosovë synon të shtojë përpjekjet për pjesëmarrje dhe avokim të organizatave të shoqërisë civile (OSHC), grupeve të grave dhe të rinjve për të punuar me institucionet komunale dhe qendrore.

Grupi i Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës ka identifikuar dhunën në baza gjinore si temë me prioritet në kuadër të aktiviteteve të veta në vitin 2016 dhe do ta zbatojë planin e veprimit për këtë temë përmes aktiviteteve të vetëdijesimit (nëpër shkolla dhe hapësira tjera publike), përfshirë përmes arteve pamore, që do të përmbillen me një ekspozitë artistike me temën e dhunës në familje të planifikuar të mbahet në qershor/korrik 2016.

Në këto suaza, **SPP-ja do të mbështesë deri në pesë OSHC nga Kosova** që punojnë në fushën e barazisë gjinore (dhe artit) për realizimin e projekteve të vogla të vetëdijesimit në partneritet me grupet e grave në nivel lokal.

**Qëllimi:**

Qëllimi i këtij aktiviteti është mbështetja/ngritja e kapaciteteve të OSHC-ve për të avokuar për të drejtat e grave dhe, në veçanti, për të zbatuar aktivitete për parandalimin e dhunës në familje.

**Detyrat:**

Të mentoruara nga SPP-ja, organizatat e shoqërisë civile që do të përzgjidhen do të:

1. Caktojnë personel që të zbatojë aktivitetet dhe detyrat në kuadër të projektit;
2. Realizojnë aktivitete të vetëdijesimit publik nëpër shkolla dhe hapësira tjera publike, duke përdorur artet pamore;
3. Organizojnë një ekspozitë artistike me temë dhunën në familje në qershor ose korrik 2016;
4. Bashkëpunojnë me grupin përkatës të grave në nivel lokal dhe zyrtarët komunal;
5. Promovojnë pjesëmarrjen e barabartë të burrave dhe grave gjatë tërë vazhdës së aktiviteteve;
6. Dorëzojnë raport përfundimtar mbi vlerësimin e projektit (minimum 5 faqe).

Në kuadër të projektit duhet të angazhohen artistë, studentë dhe/ose viktimat e dhunës të cilët do të prodhojnë vepra të arteve pamore me temën e dhunës në familje.

### **Rezultatet e pritura:**

Nën mbikëqyrjen e përgjithshme të menaxherit të projektit, aplikuesit e përzgjedhur do të dalin me rezultatet e mëposhtme:

- 1) Brenda *dy (2) javëve*, OJQ/OSHC-të e përzgjedhura duhet ta kenë konfirmuar planin përfundimtar të aktiviteteve me përfituesit dhe hisedarët tjerë të projektit;
- 2) Brenda *tre (3) muajve*, OSHC-të duhet t'i kenë realizuar punëtoritë/nismat për vetëdijesim në nivel lokal dhe t'i kenë të gatshme veprat e artit;
- 3) Brenda *tre (3) muajve*, OJQ/OSHC-të e përzgjedhura duhet ta kenë dhënë kontributin e tyre në përgatitjen dhe organizimin e ekspozitës artistike;
- 4) Brenda *katër (4) muajve*, të përgatitet raporti përfundimtar i vlerësimit ku identifikohen në mënyrë të qartë rezultatet e arritura dhe mbështeten me mjetet përkatëse të verifikimit.

### **Kohëzgjatja**

Projektet duhet të zbatohen duke filluar nga 1 maji deri më 31 korrik 2016

### **Treguesit e performancës:**

Duke u bazuar në detyrat që do t'i marrë përsipër çdo OSHC, rezultatet e pritura dhe afatet e parapara, duhet të përmbushen treguesit e mëposhtëm të performancës:

- Realizimi në kohë i aktiviteteve të vetëdijesimit publik;
- Përpilimi në kohë i gjithë materialeve të nevojshme artistike dhe rënia dakord me Misionin e OSBE-së në Kosovë për to;
- Planifikimi i rregullt i takimeve dhe dhënia e informatave më të fundit (siç përcaktohet në planin e aktiviteteve) për palët përkatëse të interesit;
- Shpалosja e gjetjeve dhe rekomandimeve për veprimet e mëtejshme në ngjarjen përmblylëse të projektit.

### **Vendi:**

Projekti i propozuar duhet të jetë i përqendruar në një komunë të caktuar në Kosovë ku vepron një struktura të regjistruara rinore.

### **Kriteret e pranueshmërisë**

- Vetëm OSHC-të e regjistruara zyrtarisht kanë të drejtë të aplikojnë për skemën e projekteve të vogla.
- Projekti duhet të jetë i ndërlidhur me temën e identifikuar në këta Terma të Referencës dhe të mos ngërthejë shumë tema përnjëherësh;
- Projekti duhet t'i ketë të integruara çështjet gjinore në kuadër të temës që synohet të adresohet;
- Projekti nuk duhet të jetë dyfishim i përpjekjeve tjera që janë në vazhdim e sipër. Në veçanti, i njëjti projekt nuk mund të mbështetet nga disa organizata;
- Projekti dhe të gjitha dokumentet shoqëruese duhet të dorëzohen në gjuhën angleze;
- Deklarata e misionit të OSHC-së duhet të jetë në pajtim me mandatin e Misionit të OSBE-së në Kosovë.

### **Buxheti**

Buxheti i projekteve duhet të jetë prej 500 – 1,500 Euro. Buxheti i projektit duhet të përmbajë vetëm shpenzimet për mallra dhe shërbime (**jo koston për personelin**) që do të menaxhohen dhe blihen drejtpërsëdrejti nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.

---

**Mënyra e aplikimit:**

- Projektpropozimi (maksimum 5 faqe, ku përfshihen a) qëllimet dhe rezultatet që do të arrihen, b) qasja dhe metodologjia që do të përdoret, c) orari i aktiviteteve, dhe d) instrumentet e vlerësimit/raportimit
- Buxheti i hollësishëm i projektit
- Biografite (CV) e pjesëtarëve të propozuar të ekipit të projektit
- Historiku i projekteve të zbatuara (maksimum 1 faqe)
- Kopja e certifikatës së regjistrimit
- Letra e qëllimit për bashkëpunim me grupin(et) e grave

Për informata të mëtejme, ju lutemi të kontaktoni z. Fitim Xharra, Departamenti i Demokratizimit, Misioni i OSBE-së në Kosovë, në [fitim.xharra@osce.org](mailto:fitim.xharra@osce.org) ose 038/240100, lokali 1154.

---